



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.830/2014

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti e me procesmbajtës Naim Shala, në konfliktin administrativ të paditësit M.V nga V. rruga “D.K” nr., kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson E.G, zyrtare ligjore, për shkak të anulimit aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të palëve, me dt.07.09.2016, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Aprovohet kërkesëpadia e paditësit, M.V nga V, si e bazuar. Anulohet aktvendimi të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë me nr.08/56/2013, i dt.11.12.2013 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Paditësi M.V, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke i propozuar gjykatës, që aktvendimin e të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë me nr.08/56/2013, të dt.11.12.2013, ta anulon në tërësi si të kundërligjshëm, për faktin se e paditura gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka refuzuar kërkesën e dt.23.08.2013, për regjistrimin e pronës-banesës.

E autorizuar e të paditurës E.G, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi të dt.14.04.2016, si dhe pranë aktvendimit të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit, të refuzohet në tërësi si e pa bazuar, ndërsa të mbetet në fuqi aktvendimi i të paditurës, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.07.09.2016, ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi i të paditurës me nr.08/56/2013, i dt.11.12.2013, kontrata e lidhur mes M.V dhe paditësit, e dt.14.07.2009, kontrata për shitblerjen e banesës e lidhur në mes M.V dhe D.M e dt.23.02.2006, kontrata për blerjen e banesës nr.853/99, e lidhur mes Fondit për Zhvillim të Republikës së Serbisë dhe D.M nga V, e dt.16.02.1999, në Beograd, si dhe përgjigja e lëshuar nga Agjencioni Kosovar i Pronës, e dt.17.10.2013 drejtuar të paditurës.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga aktvendimi i kontestuar rrjedh se, ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljt thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti

administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveq tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveq rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e aryeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekun në një mënyrë apo tjetër të drejtët dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen çart dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Akvendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetvetën dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsyeza mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e aktvendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e aktvendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “Komisioni i kadastrit të ndërtesave sipas detyrës zyrtare ka kërkuar nga Agjencia Kosovare e Pronave (KPA) të dhëna dhe verifikim të pronësisë së banesës. Komisioni i kadastrit të ndërtesave nga Agjencioni Kosovar i Pronave ka pranuar përgjigjen me numër reference 0144/13/fk të dt.17.10.2013 me shpjegimin për gjendjen aktuale të pronësisë së banesës. Sipas kësaj përgjigje për pronën banesa e cila gjendet në V, në ish Rr.”V”, objekti “K”, hyrja . kati , banesa ., në sipërfaqe prej 70.84 m2, Drejtoria kishte pranuar kërkesën e kategorisë C DS300863 të prezantuar nga D.M e cila në mbështetje të pretendimeve të kësaj kishte prezentuar vendimin e ndarjes së banesës nr.344 të dt.22.04.1996 dhe kontratën e shitblerjes nr.853/99 të dt.06.12.1999, të vërtetuar në gjykatën Komunale në Beograd, ndërsa pala përgjegjëse në këtë rast ishte F.K. Komisioni pas shqyrtimit të shkresave të lëndës me vendim HPCC/D/78/2003/C, të dt.27 qershor 2003 vendos që znj. M. ti kthehej e drejta e posedimit të pronës që kërkohej dhe se me këtë vendim janë njoftuar palët në procedurë dhe brenda afatit të parapa ligjor, Drejtoria nuk ka pranuar asnjë ankesë kundër vendimit të komisionit”.

Me kontratën mbi blerjen e banesës, e lidhur në mes D.M nga V. dhe M.V nga V si blerës, të datës;22.03.2006, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Vushtrri, në të njëjtën datë, gjykata vëren se, M.V, e ka blerë banesën në Rr.”V”, objekti “K”, hyrja kati , banesa , në sipërfaqe prej 70.84. në V nga Pronarja D.M.

Ndërsa me kontratën mbi dhurimin, e lidhur mes M.V dhe paditësit M.V nga V. me dt.14.07.2009, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Vushtrri me dt.17.07.20109, gjykata vëren se, paditësit, djali i tij M.V, i'a ka dhuruar banesën Rr.”V”, objekti “K”, hyrja 3 kati , banesa , në sipërfaqe prej 70.84 m2, e cila gjendet në V.

Në këtë kuptim gjykata gjenë se e paditura ka bërë vetëm citimin e përgjigjës së Agjencionit Kosovar të Pronave të datës;17.10.2013, e cila përgjigje i referohet vendimit të datës;27.06.2003, të lëshuar nga Agjencioni Kosovar i Pronave, me të cilën kërkueses D.M nga V, i është kthyer nga Agjencia e drejta e posedimit të banesës. Ndërsa shitblerja e banesës ka ndodhur tri vite më vonë, përkatësisht me dt.22.03.2006, në mes M.V dhe D.M, kontratë kjo e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Vushtri me dt.22.03.2006. Ku pastaj këtë banesë M.Va i'a dhuron prindit të tij, këtu paditësit M.V nga V. me kontratën e datës;14.07.2009, kontratë kjo e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Vushtri me dt.17.07.2009.

Në këtë kuptim gjykata vlerëson se, këtu paditësi e ka titullin juridik për regjistrimin paluajtshmërisë së kërkuar në librat publik dhe atë duke e bazuar në Ligjit për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, nr.2002/5, nenit 3.2 të të

njëtit, i cili përcakton se “parashtruesi që kërkon regjistrimin e të Drejtave të Pronave së Paluajtshme, kërkesës duhet t’ia bashkëngjis dokumentacionin përkatës për të mbështetur të drejtën e pronës së paluajtshme siç kërkohej me ligjin në fuqi, të përcaktuar me nenin 3.7 të këtij Ligji.

Ndërsa të drejtat mbi pronën e paluajtshme që parashihen sipas nenit 2 të Ligjit, të lartëcituar regjistrohen në bazë të: vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, vendimit të organit administrativ shtetëror, kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetent, vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga AKP, vendimit të komisionit për rindërtimi të Kadastrit, vendimit të komisionit për rregullimin e tokave dhe dokumenti tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cakura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i menjanoj të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.830/2014, dt.07.09.2014,

Procesmbajtës
Naim Shala

G j y q t a r
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.